



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:266891

Datë: 11.12.2024

Numri i dokumentit: 06579191

C.nr.6702/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtarja Albana Çeku, në çështjen juridike-kontestimore, sipas padisë së paditësit A.B, i përfaqësuar sipas autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve, ..., me seli në P., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimin e inflacionit, me datë 11.12.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR, padia e evidentuar me numër të lëndës C.nr.6702/22, e datës 14.12.2022, e paraqitur nga paditësi A.B, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimin e inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të autorizua ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimin e inflacionit.

Me datën 11.11.2024 përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, ka dorëzuar në gjykatë një parashtrësë në të cilën ka theksuar se e njofton Gjykatën se lidhur me këtë çështje juridike –kontestimore për kompensimin e infalcionit **TERHIQET**, sepse paditësi është në një procedurë tjetër.

Në lidhje me këtë, duke u bazuar në Ligjin 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, dhe Ligjin Nr.04/L-188 për Ndryshimin dhe e Plotësimin e Ligjit 03/L-006, përkatësisht në neni 261, paragrafi 3, shprehimisht është përcaktuar se; *“po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar më parë.”*

Nga sa u tha më lartë, gjykata, në bazë të nenit 261, paragrafi 3, të LPK-së, e konstatoi të tërhequr padinë e paditësit, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.6702/22 datë 11.12.2024

G j y q t a r j a
Albana Çeku

KËSHILLË JURIDIKE:

Bazuar në nenin 261, paragrafin 4, të LPK-së, kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet ankesa.